

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 855 Prot.

Tiranë, më 19.06 2017

**VENDIM Nr. 118, datë 05.06.2017**

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.9, datë 05.06.2017, pasi shqyrtoi Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik sipërfaqësor, në kuadër të *projektit HEC "MATI 1" në rrjedhën e lumit Mat*, - subjekti "MATI Hydropower" sh.p.k., realizuar nga shoqëri e licencuar në arkeologji "ABKONS" sh.p.k..

**VENDOSI:**

1. Të miratojë Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik sipërfaqësor, në kuadër të *projektit HEC "MATI 1" në rrjedhën e lumit Mat*, - subjekti "MATI Hydropower" sh.p.k., realizuar nga shoqëri e licencuar në arkeologji "ABKONS" sh.p.k., duke plotësuar përcaktimin e pikës 2 të këtij vendimi.
2. Të paraqitet nga shoqëri e licencuar në arkeologji Koncepti i kryerjes së sondazheve arkeologjike, për zonat e konsideruara me potencial të lartë arkeologjik, i cili të paraqitet në KKA e radhës. Procedura e kryerjes së sondazheve arkeologjike do të vijojë sipas përcaktimeve të vendimit të KKA të radhës.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

**KRYETAR**  
**MIRELA KUMBARO FURXHI**  
**MINISTRE**



**SEKRETAR I KKA**  
**RUDINA ZOTO**